

**LIGJI Nr. 05/L -080**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN Nr. 04/L-115**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 shtator 2011), i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 25 / 07 shtator 2012), në tekstin e mëtejshëm: Ligji.

**Neni 2**

Neni 12 i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

**Neni 12**

**Përbërja e Bordit**

1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.
2. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, emëron Drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet joshumicë si dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.
3. Kuvendi, me propozimin e Qeverisë, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit.
4. Bordi, emëron zëvendëskryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.
5. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse:
  - 5.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale;
  - 5.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi;
  - 5.3. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje

ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe

5.4. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.

6. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe punë menaxheriale.

7. Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit.

8. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendës drejtorët menaxhues nuk janë anëtar të Bordit.

### **Neni 3**

1. Neni 14, paragrafi 4 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

4. Bordi ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku pesë (5) drejtorë.

2. Neni 14, paragrafi 7 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

7. Për vendimet të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15, nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pro.

3. Neni 14, paragrafi 9 i Ligjit bazik fshihet.

### **Neni 4**

Neni 15, nën-paragrafi 2.3. i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

2.3. emërimi apo shkarkimi i Drejtorit Menaxhues, Zëvendës drejtorit Menaxhues ose të ndonjë zyrtari tjetër.

### **Neni 5**

Neni 31, paragrafi 5 i Ligjit bazik fshihet.

### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -080**  
**14 dhjetor 2015**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-036-2015, datë 24.12.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**